



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BULQIZË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**KRYESIA**

Bulqizë më 19.05.2026

**VENDIM**

**Nr.05 Datë 19.05.2026**

**MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RRADHËS.**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisje Vendore” , dhe neni 17, 56,57 dhe në mbështetje të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak Bulqizë, Kryesia e Këshillit Bashkiak Bulqizë në mbledhjen e datës 19.05.2026

**V E N D O S I:**

- 1.Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e rradhës së Këshillit Bashkiak Bulqizë, e cila do të mbahet ditën e premte, në datën 29.05.2026.
- 2.Ngarkohet Sekretari i Këshillit, në mungese Kryetari I Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te cdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë, personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari I Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**ARBEN ÇUPI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BULQIZE  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2726 Prot.

Bulqizë, më 19/05/2026

**NJOFTIM**

Bazur në Ligjin nr 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 7, neni 45, neni 53 si dhe neni 54, pika i e këtij ligji, njoftoj mbledhjen e Këshillit Bashkiak për të shqyrtuar projekt – vendimet e paraqitura nga Bashkia Bulqizë, ditën e premtë, datë 29.05.2026, ora 11:30.

1.Miratimi i rendit të ditës.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit Prill 2026, datë 11.05.2026.

3.Të ndryshme.

4. Projekt Vendim "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike ( deri në 6% ) për muajin Prill 2026 ”.

5. Projekt Vendim "Për miratimin me shkrim per dhenie ne perdorim nga fondi pyjor / kullosor dhe marrje me qera nga fondi pyjor/ kullosor me qellim hedhjen e sterilit te kromit sipas lejes minerare 473/1 date 02.08.1999”.

6. Projekt Vendim "Për miratimin me shkrim per dhenie ne perdorim nga fondi pyjor / kullosor dhe marrje me qera nga fondi pyjor/ kullosor me qellim hedhjen e sterilit te kromit sipas lejes minerare 755 date 16.03.2004”.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

